IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT



# KISHA E MANASTIRIT TË RUBIKUT

www.iktk.gov.al

Kisha e Manastirit të Rubikut është monument kulture i kategorisë së I-së, shpallur me Vendim të Institutit të Shkencave "Për nxjerrjen e listës së parë të monumenteve që vihen nën mbrojtje të Shtetit - Gazeta Zyrtare nr. 95/ dt.16.10.1948". Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, me kërkesë të Bashkisë Mirditë lidhur me gjendjen e rrënojave të Manastirit të Rubikut, u ngrit grupi i përbashkët me përfaqësues të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër për inspektim në terren. Gjatë inspektimit u konstatua se është i nevojshëm hartimi i një projekti restaurimi nga këto dy institucione, për konsolidimin e strukturës së rrënojave të këtij Manastiri duke siguruar nxjerrjen nga risku si dhe ruajtjen e vlerave të tyre si pjesë përbërëse e kompleksit të Manastirit, një vlerë e shtuar e pasurisë kulturore.





